



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 19 prill 2022
Nr.ref.:RK 1981/22

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në
rastin nr. KI216/21

Parashtrues

Kujtim Rezniki

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme
të Kosovës, Rev. nr. 81/2021, të 14 tetorit 2021**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Kujtim Rezniki, me vendbanim në Komunën e Gjakovës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin [Rev. nr. 81/2021] të 14 tetorit 2021 të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), në lidhje me Aktgjykimin [Ac. nr. 607/17] të 16 tetorit 2020 të Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) dhe Aktgjykimin [C.nr. 124/15] të 23 nëntorit 2016 të Gjykatës Themelore në Gjakovë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).
3. Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme parashtruesit të kërkesës i është dorëzuar më 16 nëntor 2021.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, për të cilin pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] në lidhje me nenin 6 [E drejta për Proces të Rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ), nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesioneve] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe nenin 1 [Mbrotjtja e Pronës] të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] e 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 26 nëntor 2021, parashtruesi i kërkesës, përmes postës, dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
7. Më 3 dhjetor 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetarja e Gjykatës caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bajram Ljatifi (kryesues), Safet Hoxha dhe Radomir Laban.
8. Më 8 dhjetor 2021, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
9. Më 10 janar 2022, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që të dorëzojë në Gjykatë formularin zyrtar të kërkesës.
10. Në të njëjtën ditë, Gjykata kërkoi nga Gjykata Themelore dosjen e plotë të lëndës.

11. Më 21 janar 2022, Gjykata pranoi nga parashtruesi i kërkesës formularin e plotësuar të kërkesës, të bashkëngjitur me kopjen e Vendimit të Arbitrit – Drejtorit Ekzekutiv të Divizionit të Rrjetit të Kompanisë Kosovare për Distributum të Energjisë Elektrike Sh.A. (në tekstin e mëtejme: KEDS) dhe vendimet e gjykatave të rregullta.
12. Më 11 shkurt 2022, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës dorëzimin e dokumenteve si në vijim: kopjet e ankesave drejtuar ish-punëdhënësit të tij pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës, përfshirë vendimet e KEDS lidhur me këto ankesa, si dhe kopjet e kërkesëpadisë, ankesës dhe revizionit drejtuar gjykatave të rregullta respektive. Në të njëjtën ditë, Gjykata përsëriti kërkesën ndaj Gjykatës Themelore për dorëzimin e dosjes së plotë të lëndës.
13. Më 14 shkurt 2022, Gjykata pranoi nga Gjykata Themelore dosjen e plotë të lëndës.
14. Më 31 mars 2022, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.
15. Më 6 prill 2022, Gjykata ktheu dosjen e plotë të lëndës në Gjykatën Themelore.

Përmbledhja e fakteve

16. Nga shkresat e lëndës rezulton se parashtruesi i kërkesës kishte qenë në marrëdhënie pune si elektrikist i matjes në Divizionin e Rrjetit, Distrikti i Gjakovës të Kompanisë Kosovare për Distributum me Energji Elektrike–KEDS (në tekstin e mëtejme: Punëdhënësi).
17. Më 2 shkurt 2015, pas zhvillimit të një procedure disiplinore kundër parashtruesit të kërkesës, Arbitri-Drejtori i Distriktit në Gjakovë, të KEDS-it kishte nxjerrë Vendim [Nr. 216] (në tekstin e mëtejme: Vendimi i Punëdhënësit, i 2 shkurtit 2015) për ndërprerjen e marrëdhënies së punës për shkak të shkeljeve të rënda të detyrave të punës, të përcaktuara me nenin 7, paragrafin 7.1, nënparagrafin (h), (r) të Kodit Disiplinor të Punëdhënësit. Në këtë vendim, ishte specifikuar se parashtruesi i kërkesës më 21 janar 2015 në bashkëpunim me kolegjin e tij, K.B., kishte përpiluar një procesverbal të orëmatësit për fshehjen e borxhit të energjisë elektrike të një konsumatori [D.P] të energjisë elektrike.
18. Më 6 shkurt 2015, parashtruesi i kërkesës te Arbitri-Drejtori Ekzekutiv i Divizionit të Rrjetit të KEDS-it në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: organi i shkallës së dytë të Punëdhënësit) paraqiti kërkesë për rishqyrtim të Vendimit të Punëdhënësit, të 2 shkurtit 2015.
19. Më 4 mars 2015, organi i shkallës së dytë të Punëdhënësit përmes Vendimit [nr. 172] refuzoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi në tërësi Vendimin e Punëdhënësit, të 2 shkurtit 2015.
20. Më 25 mars 2015, parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Themelore parashtroi kërkesëpadi për: (i) anulimin e vendimit të Punëdhënësit, të 2 shkurtit 2015, dhe Vendimit, të 4 marsit 2015 të organit të shkallës së dytë të Punëdhënësit; (ii) kthimin në vendin e tij të mëparshëm të punës si elektrikist i matjes; (iii) pagesën

e të ardhurave personale të papaguara gjatë periudhës së largimit nga puna; si dhe (iv) kompensimin e shpenzimeve të procedurës kontestimore. Në kërkesëpadinë e tij, parashtruesi i kërkesës kishte specifikuar se nuk kishte vepruar në kundërshtim me detyrat e tij të punës, gjegjësisht, nuk kishte nënshkruar procesverbalin e lartcekur për ndërrimin e orëmatësit të konsumatorit D.P.

21. Më 27 prill 2015, Punëdhënësi në Gjykatën Themelore parashtroi përgjigje në padi.
22. Më 23 nëntor 2016, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [C.nr.124/15] refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar.
23. Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit të saj vlerësoi se veprimet e Punëdhënësit ishin të drejta dhe se me rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës të parashtruesit të kërkesës nuk ka pasur parregullsi dhe shkelje ligjore. Si rezultat i administrimit të provave dhe marrjes në pyetje të dëshmitarëve gjatë seancave të saja dëgjimore, Gjykata Themelore erdhi në përfundim se edhe pse parashtruesi i kërkesës nuk e kishte nënshkruar procesverbalin e 21 janarit 2015, ai kishte qenë i pranishëm në rastin e ndërrimit të orëmatësit të konsumatori D.P. dhe nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim për paraqitje të parregullsive ekzistuese në atë rast.
24. Më 20 janar 2020, parashtruesi i kërkesës kundër Aktgjykimit [C.nr.124/15] të 23 nëntorit 2016, të Gjykatës Themelore parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit për shkak të vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Në ankesën e tij, parashtruesi i kërkesës pretendoi se dispozitivi i Aktgjykimit është kontradiktor dhe është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.
25. Më 16 tetor 2020, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac.nr.607/17] refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar dhe vërtetoi Aktgjykimin [C.nr.124/15] e 23 nëntorit 2016 të Gjykatës Themelore.
26. Gjykata e Apelit e aprovoi në tërësi arsyetimin dhe konstatimin e dhënë përmes Aktgjykimit të Gjykatës Themelore. Në këtë linjë, përkitazi me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për mosnënshkrim të procesverbalit nga ana e tij, Gjykata e Apelit vlerësoi se: *“Në këtë rast [parashtruesi i kërkesës] nuk ka ndërmarrë asnjë veprim drejtë ndaljes së kësaj lidhjeje të orëmatësit, përkundrazi ka heshtur në momentin e përpilimit të procesverbalit dhe nënshkrimit të tij nga kolegu i tij [K.B.], mbi bazën e këtyre fakteve e paditura [KEDS] kishte vërtetuar saktë gjendjen faktike me rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës [së parashtruesit të kërkesës]”*.
27. Më 1 dhjetor 2020, kundër Aktgjykimit [Ac.nr.607/17] të 16 tetorit 2020 të Gjykatës së Apelit parashtruesi i kërkesës paraqiti revizion në Gjykatën Supreme për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
28. Parashtruesi i kërkesës në revizionin e tij para Gjykatës Supreme kishte ngritur çështjet si në vijim:

- (i) në kuptim të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga Gjykata e Apelit, ai pretendoi se *“[...] ky aktgjykim ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet e, sidomos për shkak se dispozitivi i tij është i pakuptueshëm dhe kontradiktor me vetvete ose me arsyet e tij përkatësisht se nuk janë treguar arsyet për faktet vendimtare. Në rastin konkret, ekzistojnë kundërthënie në mes të dokumentacioneve të administruara dhe kontestimeve në procesverbale”* si dhe *“[...] gjykata e shkallës së dytë ka dështuar të argumentoj faktet dhe arsyet bindëse ligjore se aktgjykimi i shkallës së parë ka pasur shkelje ligjore për çka i njëjti duhet të ndryshohet”*; dhe
 - (ii) në kuptim të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, në thelb pretendoi se Gjykata e Apelit në mënyrë të gabuar ka zbatuar dispozita e Ligjit të Punës dhe të Rregullores mbi përgjegjësitë disiplinore të Punëdhënësit *“[...] kur është marrë parasysh një përgjegjësi disiplinore e paditësit e cila nuk ekziston dhe nuk është provuar në asnjë mënyrë gjatë procedurës disiplinore por edhe gjatë asaj kontestimore para gjykatës.”*
29. Më 14 tetor 2021, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev.81/2020] refuzoi si të pathemeltë revizionin e parashtruesit të kërkesës.
30. Gjykata Supreme vërtetoi arsyetimin e aktgjykimeve të gjykatave të shkallës më të ulët dhe vlerësoi se të njëjtat *“[...] nuk përfshihen me të meta e paqartësi as në dispozitiv e as në arsyetimin e tyre, përkundrazi të njëjtat janë të qarta, në arsyetimin janë dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me faktet juridikisht të vlefshme për gjykim të drejtë të kësaj çështjeje juridike, të cilat janë të pranueshme plotësisht edhe për gjykatën e revizionit, andaj këto pretendime të revizionit u refuzuan si të pabazuara”*.
31. Sipas Gjykatës Supreme, Vendimi i Punëdhënësit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së parashtruesit të kërkesës është marrë në pajtim me nenin 7, paragrafin 1, pikën f) të Kodit Disiplinor të Punëdhënësit dhe neneve 70, 72, 85 dhe 86 të Ligjit të Punës, respektivisht, nenit 70, nenit 72, nenit 85 dhe nenit 86 të Ligjit të punës, të cilat rregullojnë procedurat dhe kriteret për ndërprerjen marrëdhënies së punës.
32. Më tej, Gjykata Supreme theksoi se Vendimit të Punëdhënësit për ndërprerje të marrëdhënies së punës i ka paraprirë zhvillimi i procedurës disiplinore në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi dhe atij të aktit të brendshëm të Punëdhënësit, në të cilën procedurë është vërtetuar shkelje e rëndë të detyrave të punës.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

33. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme, në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, të 16 tetorit 2020 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, të 23 nëntorit 2016, shkel të drejtat e tij të garantuara me nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], në lidhje me nenin 6 [E drejta për Proces të Rregullt] të KEDNJ-së, nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesioneve] të Kushtetutës, si dhe nenin 1 [Mbrojtja e Pronës] të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

34. Në vijim të këtij pretendimi, parashtruesi i kërkesës nënvizon se shkeljet e dispozitave të lartcekura duhet të interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ) ashti siç është përcaktuar me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejta e Njeriut] të Kushtetutës.
35. Parashtruesi i kërkesës fillimisht konteston Aktgjykimin e Gjykatës Themelore duke pretenduar se ky i fundit përmban shkelje të rënda të procedurës kontestimore dhe se arsyetimi i tij është i paqartë, dhe kontradiktor.
36. Në vijim, parashtruesi i kërkesës po ashtu konteston Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit me pretendimin se kjo gjykatë: *“[...] gjatë procedurës ankimore, ka pasur në tërësi dokumentacionin e nevojshëm nga i cili rezulton se paditësi si punëtor në kuadër të paditurit, me asnjë veprim nuk ka cenuar detyrat e punës për tu marrë masa disiplinore ndaj tij, ajo ka pranuar konstatimin e gjykatës së shkallës së parë se paditësi [parashtruesi i kërkesës] ishte përgjegjës për shkeljen e detyrave të punës, duke u bazuar kryesisht në një deklarinim të rremë si ishte ai i dëshmitarit [K.B.] i cili këtë e kishte bërë me qëllim të dëmtimit të paditësit, meqë me të njëjtin nuk kishte raporte të mira shoqërore”*.
37. Parashtruesi i kërkesës më tej vazhdon se: *“Është konstatim i pa kuptueshëm i Gjykatës së Apelit se [parashtruesi i kërkesës] ka heshtur dhe nuk ka marrë asnjë veprim në momentin e nënshkrimit të procesverbalit në emër të tij, nga ana e dëshmitarit [K.B.]. Për cilin veprim e ka fjalën Gjykata, kur paditësi nuk ka qenë prezent në momentin e instalimit të orëmatësit në lokalin e konsumatorit [D.P.], e as që e kishte parë procesverbalin e përpiluar nga punëtori [K.B.], i cili këtë procesverbal, e kishte përpiluar dhe nënshkruar (falsifikuar) në emër të tij dhe në të paditësit, pa dijeninë dhe prezencën e tij”*
38. Tutje, në lidhje me shkeljen e nenit 49 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës pohon se: *“[...] gjatë procedurës së revizionit ndaj aktgjykimeve të gjykatës themelore dhe asaj të Apelit, ka pasur prova të mjaftueshme nga të cilat vërtetohet fakti se në rastin konkret, bëhet fjalë për mohimin e të drejtave të parashtruesit të kësaj kërkesë, në kuptimin e ndërprerjes së kundërligjshme të marrëdhënies së punës, pa ndonjë bazë ligjore e ka refuzuar Revizionin me konstatimin se aktgjykimet në fjalë janë ligjore, me çka ka mohuar të drejtën e tij për punë, e cila garantohet me dispozitat e nenit 49 të Kushtetutës së Kosovës”*.
39. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon si në vijim:

“Nga shkaqet e lartëcituara, i bindur se në rastin konkret parashtruesit të kësaj kërkesë i është mohuar e drejta themelore e njeriut që ka të bëjë me të drejtën e punës dhe ushtrimin e profesionit, i propozojmë Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës që të shpallë lundër kushtetuese këtë:

“1. Aktgjykimin e Gjykatës themelore në Gjakovë, Civ. Nr. 124/15, të dt. 23.11.2016

2. Aktgjykimin të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac. Nr. 607/17, të dt. 16.10.2020

3. Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. Nr. 81/2021, të dt. 14.10.2021, meqë me këto aktgjykime është shkelur e drejta në gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e garantua me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.”

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 22

[Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]

Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike:

- (1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;
- (2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;
- (3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj;
- (4) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare;
- (5) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor;
- (6) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas;
- (7) Konventa për të Drejtat e Fëmijës;
- (8) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese.

Amendamenti nr. 26

Në nenin 22, pas paragrafit (8) shtohet paragrafi (9), si në vijim:

(9) Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje.

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm

përfashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të medieeve, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.

4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t'u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.

5. Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.

6. Ndiurma juridike falas do t'u mundësohet atyre që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, nëse një ndihmë e tillë është e domosdoshme për të siguruar qasjen efektive në drejtësi.

7. Procedurat gjyqësore që përfshijnë të miturit rregullohen me ligj, duke respektuar rregullat dhe procedurat e veçanta për të miturit.

Neni 49

[E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit]

1. E drejta e punës garantohet.

2. Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës.

Neni 53

[Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut]

Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Neni 6

(E drejta për gjykim të drejtë)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm [...].

Prokollli nr. 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 1

(Mbrojtja e pronës)

Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera.

LIGJI NR. 03/L-006 PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE [i publikuar në Gazetën Zyrtare më 20 shtator 2008]

Neni 182

[...]

182.2 Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore ekziston gjithmonë:

[...]

n) në qoftë se aktgjykimi ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohen, e sidomos në qoftë se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm apo kontradiktor me vetvete ose me arsyet e aktgjykimit, apo nëse aktgjykimi nuk ka fare arsye apo në të nuk janë treguar fare arsyet për faktet vendimtare, ose ato arsye janë të paqarta, ose kontradiktore, ose nëse për faktet vendimtare ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet për përmbajtje të dokumentit ose të procesverbalit për thëniet e dhëna në procedurë dhe të vet atyre dokumenteve ose të procesverbalit;

[...]

Neni 204

Në arsyetimin e aktgjykimit, gjegjësisht të aktvendimit, gjykata e shkallës së dytë duhet t'i vlerësojë thëniet në ankesë që kanë qenë të rëndësishë vendimtare për dhënien e vendimit të saj.

LIGJI NR. 03/L-2012 I PUNËS [i publikuar në Gazetën Zyrtare më 1 dhjetor 2010]

Neni 85

Masat disiplinore për shkeljen e detyrave të punës

1. Për shkeljen e detyrave të punës, të punësuarit do t'i shqiptohet njëra nga këto masa ndëshkuese:

1.1. vërejtje me gojë;

1.2. vërejtje me shkrim;

1.3. ulje në pozitë;

1.4. suspendim të përkohshëm;

1.5. ndërprerje të marrëdhënies së punës.

2. Masat ndëshkuese, vërejtje me gojë, vërejtje me shkrim dhe ulje, degradim të pozitës, do të shqiptohen për shkelje të lehta të detyrave të punës në pajtim me Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit dhe Kontratën e Punës.

3. Masat ndëshkuese, suspendimi i përkohshëm dhe ndërprerja e marrëdhënies së punës, do të shqiptohen për shkelje të rënda të detyrave të punës në pajtim me Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit dhe Kontratën e Punës.

Neni 86

Shqiptimin e masave

1. Vendimin për shqiptimin e masave ndëshkuese për shkeljen e detyrave të punës, e nxjerr:

1.1. organi kompetent i punëdhënësit apo punëdhënësi;

1.2. punëdhënësi i cili nuk e ka statusin e personit juridik ose personi të cilin ai e autorizon;

2. Autorizimi nga paragrafi 1. i këtij neni jepet me shkrim;

3. Vendimi i punëdhënësit duhet të bëhet me shkrim duke theksuar arsyetimin dhe këshillën për mjetet juridike ndaj masave të shqiptuara.

KODI DISIPLINOR I KEDS-it

Neni 7

7.1. Shkelje të rënda të detyrave të punës konsiderohen:

[...]

h) keqpërdorimi nga punëmarrësi i pozitës së tij apo tejkalim i kufizimeve të autorizimit të tij, me qëllim të sigurimit të përfitimit joligjor material për vete apo ndonjë person tjetër apo ndonjë organizatë biznesore apo për të shkaktuar ndonjë dëm te personat tjerë apo organizatës biznesore”;

[...]

r) mos deklarimi i qëllimshëm apo mshejja e informatave në lidhje me ndonjë shkelje serioze apo të lehtë, duke përfshirë shkujdesin e tepruar që është pasojë e neglizhencës”.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

40. Gjykata fillimisht shqyrton nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.

41. Gjykata iu referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë se:

“(1) Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

(7) Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

42. Gjykata, më tej, i referohet neneve 47 [Kërkesat individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47 [Kërkesa individuale]

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.
2. Individit mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.

Neni 49
[Afatet]

Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor.[...]

43. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është: palë e autorizuar; konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme [Rev. nr. 81/2021] të 14 tetorit 2021; ka saktësuar të drejtat dhe liritë që pretendon se i janë shkelur; ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj, si dhe e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të përcaktuar ligjor.
44. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Paragrafi 2 i rregullit 39 të Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Specifikisht, paragrafi 2 i rregulli 39 të Rregullores së punës përcakton që:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

45. Bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ) por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”; dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta”. Këtë koncept të papranueshmërisë mbi bazën e një kërkesë të vlerësuar si “qartazi të pabazuar”, dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si “qartazi të pabazuara” të zhvilluara përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata i ka përvetësuar edhe në praktikën e

saj gjyqësore përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet KI40/20 me parashtrues *Sadik Gashi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 20 janarit 2021; KI163/18, me parashtrues *Kujtim Lleshi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 24 qershorit 2020; KI21/21, me parashtrues, *Asllan Meka*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 28 prillit 2021, KI107/21, me parashtrues *Ramiz Hoti*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 21 tetorit 2021).

46. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, në vlerësimin nëse e njëjta është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
47. Në këtë aspekt, dhe fillimisht, Gjykata rikujton që rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me Vendimin e Punëdhënësit, të 2 shkurtit 2015 për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të parashtruesit të kërkesës, përmes të cilit pas zhvillimit të procedurës disiplinore ndaj tij ishte konstatuar se ai kishte kryer shkelje të rëndë të detyrave të punës. Kundër këtij Vendimi të Punëdhënësit, të 2 shkurtit 2015, parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur ankesë te organi i shkallës së dytë të Punëdhënësit. Ky i fundit përmes Vendimit të tij, të 4 marsit 2015 në tërësi kishte vërtetuar gjetjet e konstatuara përmes Vendimit, të 2 shkurtit 2015. Për pasojë, parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Themelore kishte parashtruar kërkesëpadi, ndër tjerash duke kërkuar (i) anulimin e dy vendimeve të Punëdhënësit të 2 shkurtit 2015 dhe 4 marsit 2015, respektivisht dhe (ii) kthimin në vendin e tij të mëparshëm të punës. Parashtruesi i kërkesës, në thelb pretendoi se nuk kishte vepruar në kundërshtim me detyrat e tij të punës, respektivisht, nuk kishte dhënë miratimin për instalimin e orëmatësit të ri në lokalin afarist të konsumatorit D.P. dhe nuk kishte nënshkruar procesverbalin për ndërrimin e orëmatësit. Në procedurën e zhvilluar kontestimore, më 23 nëntor 2016, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [C. Nr. 124/15] kishte refuzuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar me arsyetimin se veprimet e Punëdhënësit kanë qenë të drejta dhe se me rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës të parashtruesit të kërkesës, nuk ka pasur parregullsi si dhe shkelje ligjore. Pas administrimit të provave dhe marrjes në pyetje të dëshmitarëve gjatë seancave dëgjimore të mbajtur në këtë gjykatë, Gjykata Themelore kishte konkluduar se edhe pse parashtruesi i kërkesës nuk e kishte nënshkruar procesverbalin e 21 janarit 2015, ai kishte qenë i pranishëm në rastin e ndërrimit të orëmatësit të konsumatorit D.P. dhe nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim për paraqitje të parregullsive ekzistuese në atë rast. Si rezultat i ankesës së parashtruesit të kërkesës kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjykatën e Apelit, kjo e fundit përmes Aktgjykimit [Ac. Nr. 607/17] të 1 dhjetorit 2020 kishte vërtetuar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, të 23 nëntorit 2016. Si rezultat i revizionit të parashtruesit të kërkesës në Gjykatën Supreme, kjo e fundit përmes Aktgjykimit [Rev. Nr. 81/2021] revizionin e tij e kishte refuzuar si të pathemeltë.
48. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës i konteston konstatimet e gjykatave të rregullta duke pretenduar shkelje të të drejtave të tij të garantuara me nenin

31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, nenin 49 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Po ashtu, parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij pretendon shkelje të nenit 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] të Kushtetutës.

49. Sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] Gjykata vë në pah se kjo dispozitë kushtetuese përcakton instrumentet ndërkombëtare të cilat janë drejtpërdrejtë të zbatueshme në rendin juridik të Republikës së Kosovës.
50. Bazuar në atë si më lart, Gjykata në vijim do të vlerësojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të: (i) nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së; dhe (ii) neneve 49 të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

I. Përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së

51. Gjykata fillimisht vë në pah, se parashtruesi i kërkesës konteston arsyetimin e Aktgjykimit të Gjykatës Themelore dhe atij të Gjykatës së Apelit që ndërlidhen me vërtetimin e gjendjes faktike dhe zbatimit të së drejtës materiale, të vërtetuar edhe përmes Aktgjykimit të Gjykatës Supreme.
52. Në lidhje me këtë, Gjykata konsideron se ky pretendim i ngritur në kuptim të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së ndërlidhet me konstatimin e gjykatave të rregullta përkitazi me ndërprerjen e marrëdhënies së tij të punës dhe si i tillë bie në kategorinë e pretendimeve “të shkallës së katërt”, sepse ngërthen çështje që ndërlidhen me interpretimin dhe aplikimin e ligjit, përkatësisht “ligjshmërisë” dhe jo “kushtetutshmërisë”.
53. Gjykata ka pohuar vazhdimisht se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe se ajo nuk mund të vlerësojë vetë faktet të cilat e kanë bërë një gjykatë të rregullt të marrë një vendim, e jo një tjetër. Në të kundërtën, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “shkallës së katërt”, që do të rezultonte në shpërfilljen e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj (shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së *García Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe referencat e përdoruar aty; dhe shih, gjithashtu rastet e Gjykatës, KI49/19, parashtrues *Shoqëria Aksionare Limak Kosovo International Airport S.H.A.*, “*Adem Jashari*”, Aktvendim i 31 tetorit 2019, paragrafi 48; dhe KI154/17 dhe KIO5/18, me parashtrues *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “BARBAS”*, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 korrikut 2019, paragrafi 61).
54. Gjykata Kushtetuese mund të bëjë vlerësimin e interpretimeve ligjore të gjykatave të rregullta përjashtimisht dhe atë vetëm nëse ato interpretime mund të kenë rezultuar në konkluzione arbitrare ose qartazi të paarsyeshme (shih rastin e Gjykatës KI75/17, me parashtrues X, të cituar më lart, paragrafi 59).

55. Në lidhje me pretendimin e lartcekur të parashtruesit të kërkesës, Gjykata vëren se të gjitha vendimet e gjykatave të rregullta ofruan arsyetimin përkatës për refuzimin e kërkesëpadisë së tyre. Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit vërtetuan se Vendimi i Punëdhënësit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të parashtruesit të kërkesës, i 2 shkurtit 2015 ishte nxjerrë në pajtim me dispozita ligjore në fuqi duke konstatuar se edhe pse parashtruesi i kërkesës nuk e kishte nënshkruar procesverbalin e 21 janarit 2015, ai kishte qenë i pranishëm në rastin e ndërrimit të orëmatësit të konsumatori D.P. dhe nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim për paraqitje të parregullsive ekzistuese në atë rast.
56. Në vijim, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës në revizionin e tij kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të parashtruar në Gjykatën Supreme kishte pretenduar: (i) shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore me arsyetimin se Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit ishte i pakuptueshëm dhe kontradiktor me vetvete ose me arsyet e tij, përkatësisht nuk ishin saktësuar arsyet për faktet vendimtare; dhe (ii) zbatim të gabuar të drejtës materiale me arsyetimin se Gjykata e Apelit në mënyrë të gabuar ka zbatuar dispozitat e Ligjit të Punës dhe të Rregullores mbi përgjegjësitë disiplinore të Punëdhënësit *“[...] kur është marrë parasysh një përgjegjësi disiplinore e paditësit e cila nuk ekziston dhe nuk është provuar në asnjë mënyrë gjatë procedurës disiplinore por edhe gjatë asaj kontestimore para gjykatës.”*
57. Në fund, Gjykata i referohet edhe Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, përmes të cilës kjo e fundit, ndër tjerash, kishte vërtetuar konstatimet e gjykatave të shkallës më të ulët përmes aktgjykimeve të tyre, duke theksuar se të njëjtat janë të qarta dhe përmbajnë arsyetim të mjaftueshëm përkitazi me gjendjen faktike. Përfundimisht, Gjykata Supreme kishte konstatuar se Vendimi i Punëdhënësit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së parashtruesit të kërkesës, i 2 shkurtit 2015 është marrë në pajtim me nenin 7, paragrafin 1, pikën f) të Kodit Disiplinor të Punëdhënësit dhe neneve 70, 72, 85 dhe 86 të Ligjit të Punës, respektivisht, nenit 70, nenit 72, nenit 85 dhe nenit 86 të Ligjit të punës, të cilat rregullojnë procedurat dhe kriteret për ndërprerjen marrëdhënies së punës.
58. Bazuar në arsyetimin e dhënë nga Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit të saj, Gjykata vëren se kjo e fundit ka arritur në këtë përfundim pas shqyrtimit të konstatimeve të dhëna përmes aktgjykimeve të Gjykatës Themelore dhe të Gjykatës së Apelit dhe adresimit të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës të ngritura në revizionin e tij para kësaj gjykate.
59. Në dritën e fakteve të mësipërme, Gjykata e konsideron të nevojshme të vë në pah se parashtruesit të kërkesës i është mundësuar zhvillimi i procedurës bazuar në parimin e kontradiktoritetit; se ai ka mundur që gjatë fazave të ndryshme të procedurës të paraqes argumente dhe dëshmi që ai i konsideronin të rëndësishme për rastin e tij; dhe se të gjitha argumentet, shikuar objektivisht, që ishin relevante për zgjidhjen e rastit të tij janë dëgjuar e shqyrtuar në mënyrë të rregullt nga gjykatat; se arsyet faktike e ligjore ndaj vendimeve të goditura ishin shqyrtuar hollësisht; dhe se, në përputhje me rrethanat e rastit, procedurat, shikuar në tërësinë e tyre, ishin të drejta.
60. Prandaj, duke marrë për bazë atë që është cekur më lart, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës, nuk mbështet mjaftueshëm dhe as nuk argumenton para

Gjykatës, se si këto interpretime të dispozitave përkatëse ligjore, të bëra nga Gjykata Supreme dhe gjykatat e rregullta, kanë rezultuar në konkluzione arbitrare ose qartazi të paarsyeshme në rastin e tij apo se si procedurat para gjykatave të rregullta, në tërësinë e tyre, mund të mos kenë qenë të drejta apo edhe të kenë qenë arbitrare.

61. Prandaj bazuar në si më lart, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk kanë mbështetur se si vendimet e gjykatave të rregullta, në veçanti Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme, ka shkelur të drejtën e tij të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Rrjedhimisht, Gjykata arrin në përfundim se ky pretendim i parashtruesit të kërkesës është qartazi i pabazuar mbi baza kushtetuese ashtu siç është përcaktuar me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

II. Përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 49 të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së

62. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes aktgjykimeve të gjykatave të rregullta, në veçanti përmes Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme atij i është mohuar e drejta e tij në punë dhe ushtrimin të profesionit, e garantuar me nenin 49 të Kushtetutës.
63. Në vijim, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon shkelje të së drejtës së tij në pronë, e garantuar me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Në lidhje me këtë të fundit, parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij vetëm ka vendosur se i janë shkelur: “*Të drejtat e përcaktuara në nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ-së*” por nuk ka dhënë as edhe një sqarim apo arsyetim konkret se si kjo e drejtë është shkelur në rastin e tij.
64. Megjithatë, Gjykata duke u bazuar në shkresat e dosjes së rastit, gjen se parashtruesi i kërkesës në parashtrësia e tij para gjykatave të rregullta nuk kishte specifikuar shkelje të nenit 49 të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, dhe si të tilla këto pretendime nuk ishin objekt i shqyrtimit dhe vlerësimit nga gjykata e rregullta. Për më tepër, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore kishte parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit dhe më pas edhe revizion në Gjykatën Supreme. Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës, respektivisht ankesa në Gjykatën e Apelit dhe revizioni i parashtruar në Gjykatën Supreme nuk rezulton që pretendimet e lartcekura të parashtruesit të kërkesës të jenë ngritur në këto dy parashtrësia.
65. Gjykata rithekson se shterimi i mjeteve juridike ngërthen në vete dy elemente: (i) atë të shterimit në kuptimin formal-procedural, që nënkupton mundësinë e përdorimit të mjetit juridik, kundër një akti të një autoriteti publik, në një instancë më të lartë me juridiksion të plotë; dhe (ii) shterimin e mjetit në kuptimin substancial, që nënkupton raportimin e shkeljeve kushtetuese në “*substancë*” para gjykatave të rregullta në mënyrë që këto të fundit të kenë mundësinë e parandalimit dhe të korrigjimit të shkeljes së të drejtave të njeriut të mbrojtura me Kushtetutë dhe KEDNJ. Gjykata i konsideron si të shterura mjetet juridike vetëm atëherë kur parashtruesit e kërkesës, në pajtueshmëri me ligjet në fuqi, i kanë shfrytëzuar ato, në të dy kuptimet (shih, po ashtu, rastet e Gjykatës, KI71/18, parashtrues, *Kamer Borovci, Mustafë Borovci dhe Avdulla*

Bajra, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 nëntorit 2018, paragrafin 57; rastin KI119/17, cituar më lart, paragrafin 73; rastin KI154/17 dhe KIO5/18, cituar më lart, paragrafi 94; dhe rastin KI163/18, cituar më lart, paragrafi 61).

66. Një qëndrim i tillë është në përputhshmëri të plotë me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, bazuar në të cilën, për aq sa ekziston një mjet juridik që ua mundëson gjykatave të rregullta të adresojnë, të paktën në substancë, argumentin për shkelje të një të drejte, atëherë ai mjet juridik duhet të shfrytëzohet. Nëse ankesa e paraqitur në Gjykatë nuk është ngritur, qoftë në mënyrë eksplicite apo në substancë, pranë gjykatave të rregullta kur ka mundur të ngrihet gjatë ushtrimit të një mjeti juridik në dispozicion të parashtruesit të kërkesës, atëherë gjykatave të rregullta u është mohuar mundësia e adresimit të çështjes, mundësi të cilën rregulli për shterimin e mjeteve juridike synon ta ofrojë (shih, ndër tjerash, rastin e GJEDNJ-së, *Jane Nicklinson kundër Mbretërisë së Bashkuar dhe Paul Lamb kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, paragrafi 90 dhe referencat e përfshira aty; dhe shih, gjithashtu, rastin e Gjykatës, KI119/17, cituar më lart, paragrafin 72; rastin KI154/17 dhe KIO5/18, cituar më lart, paragrafi 93; rastin KI155/18, cituar më lart, paragrafi 49; dhe rastin KI163/18, me parashtrues *Kujtim Lleshi*, i cituar më lart, paragrafi 60).
67. Marrë parasysh këto parime dhe në rrethana në të cilat, sipas shkresave të lëndës rezulton se këto pretendime specifike të parashtruesit të kërkesës janë ngritur për herë të parë para Gjykatës, ajo konkludon që parashtruesi i kërkesës nuk i ka dhënë mundësinë Gjykatës së Apelit dhe asaj Supreme, që të adresojnë këto pretendime dhe me atë rast, të parandalojnë shkeljet e pretenduara që parashtruesi i kërkesës i ngrit drejtpërdrejt pranë kësaj Gjykate, pa i shteruar mjetet juridike në kuptimin e tyre substancial (shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës, KI118/15, parashtrues *Dragiša Stojković*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 prillit 2016, paragrafët 30-39; rastin KI119/17, me parashtrues *Gentian Rexhepi*, Aktvendim për papranueshmëri i 3 majit 2019, paragrafi 74; rastin KI154/17 dhe KIO5/18, me parashtrues *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "BARBAS"*, Aktvendim për papranueshmëri i 13 gushtit 2019, paragrafi 95; dhe rastin KI163/18, me parashtrues *Kujtim Lleshi*, i cituar më lart, paragrafi 62).
68. Si rrjedhojë, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 49 të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së duhet të refuzohen si të papranueshme për shkak të mosshterimit substancial të të gjitha mjeteve juridike, siç kërkohet me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafin 2 të nenit 47 të Ligjit dhe pikën (b) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113. 7 të Kushtetutës, me nenin 20, nenin 47.2 dhe nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 39 (1) (b) dhe (d) dhe (2) të Rregullores së punës, më 31 mars 2022, njëzëri;

VENDOS

- I. TË SHPALLË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtare raportuese

Remzije Istrefi-Peci



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani